



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.148

23 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1258, datë 17.9.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.1222, datë 3.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura e Çerenecit” 7299
Udhëzim i përbashkët i MF dhe MASH nr.27, datë 23.7.2008	Për procedurat e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar 7309
Udhëzim i MMPAU nr.4, datë 12.9.2008	Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor 7315
Udhëzim i METE nr.355, datë 21.5.2008	Për rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e sekretarëve të dhomave të tregtisë dhe industrisë në qarqe dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë 7325
Udhëzim i METE nr.671, datë 12.9.2008	Për realizimin dhe paraqitjen e kontratave të sigurimit për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë 7326
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1662, datë 25.8.2008	Për kriteret e përdorimit të fondit të pashpërndarë të mbrojtjes sociale..... 7328
Urdhër i MMPAU nr.350, datë 5.9.2008	Për miratime e statusit të organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Liqeni i Fierzës, Kukës) 7337
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Hajdar Hasan Kasa 7338

VENDIM
Nr.1258, datë 17.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1222, DATË 3.9.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR BULQIZË-URA E ÇERENECIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1222, datë 3.9.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 40 997 (dyzet mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m² tokë arë, me një vlerë shpronësimi 7 166 704 (shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e katër) lekë, për sipërfaqen 108 (njëqind e tetë) m², tokë truall, me një vlerë shpronësimi 47 196 (dyzet e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 213 900 (shtatë milionë e dyqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
Qarku Dibër, komuna Zerqan, Fshati Sofraçan

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1.	Muharrem	Mexhit	Nuci	3491	85/3	60	84	5040	0		0	5040	Plot.dok
2.	Selim	Isuf	Cani	3491	85/2	306	84	25704	0		0	25704	Plot.dok
3.	Muharrem	Sadik	Cani	3491	85/1	345	84	28980	0		0	28980	Plot.dok
4.	Bibe	Merdan	Cani	3491	84/7	58	84	4872	0		0	4872	Plot.dok
5.	Mexhit	Veli	Nuci	3491	84/8	228	84	19152	0		0	19152	Plot.dok
6.	Sadik	Jashar	Shahini	3491	84/4	121	84	10164	0		0	10164	Plot.dok
7.	Artur	Haki	Nuci	3491	84/2	169	84	14196	0		0	14196	Plot.dok
8.	Ilmi	Muharem	Elmazi	3491	47/1	450	84	37800	0		0	37800	Plot.dok
	SHUMA					1737		145908			0	145908	

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
Qarku Dibër, komuna Zerqan, fshati Valikardhe

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1.	Lime		Allushi	3706	308/5	244	218	53192	0		0	53192	Plot.dok
2.	Shefqet	Osman	Zeneli	3706	308/4	704	218	153472	0		0	153472	Plot. dok
3.	Osman	Selim	Zeneli	3706	308/2	273	218	59514	0		0	59514	Plot. dok
4.	Idriz	Osman	Zeneli	3706	308/1	620	218	135160	0		0	135160	Plot. dok
5.	Bajram	Hamet	Hyka	3706	309/10	1200	218	261600	0		0	261600	Plot. dok
6.	Lahim	Mustafa	Zogu	3706	309/14	650	218	141700	0		0	141700	Plot. dok
7.	Idriz	Osman	Zeneli	3706	308/3	357	218	77826			0	77826	Plot. dok
8.	Bujar	Mustafa	Zogu	3706	309/13	463	218	100934	0		0	100934	Plot. dok
9.	B.Pr.Ylli Rakip Hoxha, Gëzim Hasan Hoxha			3706	296/2	426	218	92868	0		0	92868	Plot. dok
	Shuma					4937		1076266			0	1076266	

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
Qarku Dibër, komuna Zerqan, fshati Godvi

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1	Skënder	Tahir	Fiku	1824	97/4	280	197	55160	0		0	55160	Plot.dok
2	Ilmi	Tahir	Fiku	1824	97/6	290	197	57130	0		0	57130	Plot. dok
3	Muharrem	Hamit	Fiku	1824	213/1	320	197	63040	0		0	63040	Plot. dok
4	Ibrahim	Hamit	Fiku	1824	213/2	504	197	99288	0		0	99288	Plot. dok
5	Aqif	Shaban	Fiku	1824	29/5	400	197	78800	0		0	78800	Plot. dok
6	Ismail	Aqif	Fiku	1824	29/4	120	197	23640	0		0	23640	Plot. dok
	Shuma					1914		377058			0	377058	

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
Qarku Dibër, komuna Fushë-Bulqizë, fshati Dragu

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË		TOTALI	SHËNIME
						Arë	Truall		

						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1	Pëllumb	Mehmet	Boba	1532	529	84	116	9744	0		0	9744	Plot.dok
2	Pëllumb	Mehmet	Boba	1532	528	144	116	16704	0		0	16704	Plot. dok
3	Bajram	Isuf	Boba	1532	255/1	130	116	15080	0		0	15080	Plot. dok
4	Isuf	Mehmet	Boba	1532	255/2	240	116	27840	0		0	27840	Plot. dok
5	Halit	Sulejman	Boba	1532	226/1	25	116	2900	0		0	2900	Plot. dok
	Shuma					623		72268			0	72268	

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
Qarku Dibër, komuna Zerqan, fshati Krajke

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1	Ali		Mera	2262	98/1	52	246	12792			0	12792	Plot.dok

2	Ali	Ferit	Nela	2262	99/2	135	246	33210			0	33210	Plot.dok
3	Xheladin	Bajram	Mera	2262	100/8	208	246	51168			0	51168	Plot.dok
4	Ali	Tal	Mera	2262	100/9	115	246	28290			0	28290	Plot.dok
5	Ismail	Ferit	Kurcani	2262	100/14	117	246	28782			0	28782	Plot.dok
6	Xhezmi	Asllan	Mera	2262	114/4	735	246	180810			0	180810	Plot.dok
7	Dilaver	Ali	Hoxha	2262	111/2	450	246	110700			0	110700	Plot.dok
8	Xheladin	Jaho	Mera	2262	29/1	30	246	7380			0	7380	Plot.dok
9	Skënder	Tal	Mera	2262	29/2	45	246	11070			0	11070	Plot.dok
10	Dashamir	Ali	Mera	2262	109/1	125	246	30750			0	30750	Plot.dok
11	Sabri	Dilaver	Mera	2262	109/2	312	246	76752			0	76752	Plot.dok
12	Defrim	Selim	Mera	2262	29/9	885	246	217710			0	217710	Plot.dok
13	Bajram	Hysen	Mera	2262	29/10	728	246	179088			0	179088	Plot.dok
14	Beshir	Dilaver	Dervishi	2262	38/1	1875	246	461250			0	461250	Plot.dok
15	Bajram	Dan	Mera	2262	29/8	292	246	71832			0	71832	Plot.dok
16	Defrim	Dilaver	Mera	2262	29/7	285	246	70110			0	70110	Plot.dok
17	Sabri	Hysen	Mera	2262	29/4	255	246	62730			0	62730	Plot.dok
18	Agim	Selim	Kurcani	2262	111/1	687	246	169002			0	169002	Plot.dok
19	Muharem	Muharem	Mera	2262	112/3	100	246	24600			0	24600	Plot.dok
20	Skënder	Ali	Mera	2262	112/2	135	246	33210			0	33210	Plot.dok
21	Mite	Ali	Mera	2262	112/1	185	246	45510			0	45510	Plot.dok
22	Lutfi	Sadik	Kurcani	2262	126/9	85	246	20910			0	20910	Plot.dok
23	Muharem	Shaban	Mera	2262	126/7	18	246	4428			0	4428	Plot.dok
24	Ilir	Ali	Lami	2262	115/7	132	246	32472			0	32472	Plot.dok
25	Lutfie	Ramadan	Cani	2262	115/15	176	246	43296			0	43296	Plot.dok

26	Skënder	Rifat	Mera	2262	115/14	126	246	30996			0	30996	Plot.dok
27	Feride	Ali	Beka	2262	115/6	108	246	26568			0	26568	Plot.dok
28	Petrit	Xhemal	Kurcani	2262	115/4	80	246	19680			0	19680	Plot.dok
29	Lutfi	Shaban	Kurcani	2262	115/3	85	246	20910			0	20910	Plot.dok
30	Abaz	Shaban	Beka	2262	115/8	180	246	44280				44280	
31	Moiz	Hajredin	Beka	2262	115/7	120	246	29520				29520	
32	Ismail	Asllan	Kurcani	2262	100/15	52	246	12792				12792	
	Shuma			2262		8913		2192598				2192598	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
 BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT
 Qarku Dibër, bashkia Bulqizë, fshati Vajkal

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	

1	Liman	Mexhit	Voci	3694	752/3	156	197	30732	0		0	30732	Plot.dok
2	Haki	Isuf	Dauti	3694	755/1	360	197	70920	0		0	70920	Plot.dok
3	Sadik	Ali	Sadiku	3694	767/1	200	197	39400	0		0	39400	Plot.dok
4	Afrim	Hid	Sula	3694	767/3	138	197	27186	0		0	27186	Plot.dok
5	Halit	Bilal	Sula	3694	767/7	90	197	17730	0		0	17730	Plot.dok
6	Hajrie	Isuf	Sula	3694	767/10	90	197	17730	0		0	17730	Plot.dok
7	Faik	Hysen	Tançi	3694	770	50	197	9850	0		0	9850	Plot.dok
8	Nimetalie	Hysen	Tançi	3694	775	50	197	9850	0		0	9850	Plot.dok
9	Ismet	Hysen	Tançi	3694	776	50	197	9850	0		0	9850	Plot.dok
10	Kujtim	Hysen	Tançi	3694	781	50	197	9850	0		0	9850	Plot.dok
11	Hajdar	Hysen	Tançi	3694	782	50	197	9850	0		0	9850	Plot.dok
12	Rifat	Bajram	Tançi	3694	786	100	197	19700	0		0	19700	Plot.dok
13	Ilmi	Bajram	Tançi	3694	789	100	197	19700	0		0	19700	Plot.dok
14	Dalip	Bajram	Tançi	3694	791	125	197	24625	0		0	24625	Plot.dok
15	Shëfqet	Elmaz	Tançi	3694	1463/2	90	197	17730	0		0	17730	Plot.dok
16	Mite	Bajazit	Kola	3694	1462/2	72	197	14184	0		0	14184	Plot.dok
17	Moiz	Kamber	Tançi	3694	1462/1	90	197	17730	0		0	17730	Plot.dok
18	Afrim	Hid	Sula	3694	1503	506	197	99682	0		0	99682	Plot.dok
19	Alfred	Besnik	Tançi	3694	1464/5	56	197	11032	0		0	11032	Plot.dok
20	Alfred	Besnik	Tançi	3694	1467/1	48	197	9456	0		0	9456	Plot.dok
21	Hysen	Jonuz	Ceni	3694	1469/1	72	197	14184	0		0	14184	Plot.dok
22	Sulejman	Qazim	Aliaj	3694	1469/2	88	197	17336	0		0	17336	Plot.dok
23	Bedri	Halit	Aliaj	3694	1472/1	32	197	6304	0		0	6304	Plot.dok
24	Fatmir	Halit	Aliaj	3694	1472/2	32	197	6304	0		0	6304	Plot.dok
25	Kapllan	Hamit	Aliaj	3694	1472/3	32	197	6304	0		0	6304	Plot.dok
26	Roland	Destan	Aliaj	3694	1472/4	32	197	6304	0		0	6304	Plot.dok
27	Qamil	Mustafa	Sula	3694	1473	64	197	12608	0		0	12608	Plot.dok
28	Xhemile	Hysen	Sula	3694	1476/1	60	197	11820	0		0	11820	Plot.dok
29	Sahade	Adem	Hoxha	3694	1476/2	70	197	13790	0		0	13790	Plot.dok
30	Sadie	Fasli	Sadiku	3694	764	100	197	19700	0		0	19700	Plot.dok
31	Afrim	Hid	Sula	3694	763	30	197	5910	0		0	5910	Plot.dok
32	Alfred	Besnik	Tançi	3694	1464/3	96	197	18912	0		0	18912	Plot.dok
33	Diamant	Sadik	Hoxha	3694	1482/2	36	197	7092	0		0	7092	Plot.dok
34	Zaide	Selman	Balla	3694	909	200	197	39400	0		0	39400	Plot.dok
35	Ismail	Riza	Balla	3694	910	388	197	76436	0		0	76436	Plot.dok
36	Hysni	Hysen	Balla	3694	912	667	197	131399	0		0	131399	Plot.dok
37	Hysni	Hysen	Balla	3694	913	660	197	130020	0		0	130020	Plot.dok
38	Tushe	Mustafa	Lika	3694	915	589	197	116033	0		0	116033	Plot.dok
39	Tushe	Mustafa	lika	3694	1057	216	197	42552	0		0	42552	Plot.dok
40	Kujtim	Fadil	Ternova	3694	1059	112	197	22064	0		0	22064	Plot.dok
41	Tushe	Mustafa	Lika	3694	1426	220	197	43340	0		0	43340	Plot.dok
42	Kujtim	Fadil	Ternova	3694	1425/1	561	197	110517	0		0	110517	Plot.dok
	Shuma					6828		1345116			0	1345116	

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
BULQIZË-BLLATË-URA E ÇERENECIT

Qarku Dibër, Komuna Fushë- Bulqizë, fshati Fushë-Bulqizë

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADAST.	NR. PASURISË	LLOJI I PASURISË						TOTALI	SHËNIME
						Arë			Truall				
						M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	M ²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lekë	
1	Muharem	Hamit	Zeneli	1660	11	495	122	60390	0		0	60390	Plot.dok
2	Gëzim	Lahim	Zeneli	1660	10	320	122	39040	0		0	39040	Plot.dok
3	Shkëlqim	Abdulla	Gjini	1660	131	130	122	15860	0		0	15860	Plot.dok
4	Hasan	Jonuz	Kica	1660	128	70	122	8540	0		0	8540	Plot.dok
5	Riza	Hajredin	Kica	1660	127	300	122	36600	0		0	36600	Plot.dok
6	Hasan	Jonuz	Kica	1660	125	383	122	46726	0		0	46726	Plot.dok
7	Rifat	Seit	Kola	1660	124	210	122	25620	0		0	25620	Plot.dok
8	Agron	Tahir	Kica	1660	47	256	122	31232	0		0	31232	Plot.dok
9	Hamza	Sulejman	kica	1660	68	40	122	4880	0		0	4880	Plot.dok
10	Rabie	Hysen	Kica	1660	72	54	122	6588	0		0	6588	Plot.dok
11	Bilal	Shahin	Kola	1660	123	75	122	9150	0		0	9150	Plot.dok
12	Shpëtim	Hasan	Kola	1660	114	300	122	36600	0		0	36600	Plot.dok
13	Seit	Shahin	Kola	1660	108	192	122	23424	0		0	23424	Plot.dok
14	Riza	Hajredin	Kica	1660	83	231	122	28182	0		0	28182	Plot.dok
15	Sadete	Dile	Gjini	1660	89	72	122	8784	0		0	8784	Plot.dok
16	Arben	Isuf	Kola	1660	90	120	122	14640	108	437	47196	61836	Plot.dok
17	Ramadan	Hysen	Dedja	1660	603	1150	122	140300	0		0	140300	Plot.dok
18	Rexhep	Bajram	Doga	1660	609/2	420	122	51240	0		0	51240	Plot.dok
19	Veli	Izet	Doga	1660	669/1	195	122	23790	0		0	23790	Plot.dok
20	Riza	Hysen	Xhafa	1660	971/2	108	122	13176	0		0	13176	Plot.dok
21	Rakip	Hysen	Xhafa	1660	971/1	108	122	13176	0		0	13176	Plot.dok
22	Hysen	Ali	Balja	1660	935	300	122	36600	0		0	36600	Plot.dok
23	Sadete	Dile	Gjini	1660	200	276	122	33672	0		0	33672	Plot.dok
24	Petrit	Ramadan	Xhafa	1660	981	132	122	16104	0		0	16104	Plot.dok
25	Petrit	Ramadan	Xhafa	1660	980	900	122	109800	0		0	109800	Plot.dok
26	Merjeme	Muharem	Balja	1660	737	255	122	31110	0		0	31110	Plot.dok
27	Hysen	Ali	Balja	1660	935	300	122	36600	0		0	36600	Plot.dok

28	Hysen	Ali	Balja	1660	936	300	122	36600	0		0	36600	Plot.dok
29	Abdulla	Adem	Xhafa	1660	747	80	122	9760	0		0	9760	Plot.dok
30	Besim	Hamit	Gjura	1660	754	256	122	31232	0		0	31232	Plot.dok
31	Fiqiri	Bilal	Gjura	1660	755	160	122	19520	0		0	19520	Plot.dok
32	Kujtim	Maliq	Kuka	1660	761	994	122	121268	0		0	121268	Plot.dok
33	Mustafa	Maliq	Kuka	1660	764	1178	122	143716	0		0	143716	Plot.dok
34	Muharem	Maliq	Kuka	1660	766	624	122	76128	0		0	76128	Plot.dok
35	Shefqet	Hasan	Daka	1660	921	1452	122	177144	0		0	177144	Plot.dok
36	Latif	Sulejman	Doda	1660	795	60	122	7320	0		0	7320	Plot.dok
37	Selman	Tahir	Doda	1660	793	480	122	58560	0		0	58560	Plot.dok
38	Mehmet	Hysen	Xhafa	1660	791	400	122	48800	0		0	48800	Plot.dok
39	Riza	Hysen	Xhafa	1660	790	192	122	23424	0		0	23424	Plot.dok
40	Artur	Fiqiri	Gjura	1660	759	144	122	17568	0		0	17568	Plot.dok
41	Petrit	Ramadan	Xhafa	1660	992	493	122	60146	0		0	60146	Plot.dok
42	Selman	Jonuz	Perkola	1660	639	1570	122	191540	0		0	191540	Plot.dok
43	Albert	Sadik	Daka	1660	959	160	122	19520	0		0	19520	Plot.dok
44	Qamil	Abdulla	Xhafa	1660	745	110	122	13420	0		0	13420	Plot.dok
	Shuma					16045		1957490	108	437	47196	2004686	

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.27, datë 23.7.2008

**PËR PROCEDRUAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT “PËR
BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE UNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit vitit 2008”, të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.260, datë 18.4.2007 “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.266, datë 22.5.1995 “Për subvencionimin e një pjese të çmimeve të botimeve të Shtëpisë Botuese të Librit Universitar”, Ministri i Financave dhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës

UDHËZOJNË:

Procedurat për përdorimin e fondeve buxhetore, dhënë nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës (MASH), për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar, janë si vijon:

A. Për tekstet shkollore në arsimin parauniversitar:

1. Procesi i botimit, shtypjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.260, datë 18.4.2007 “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, realizohet nga shtëpitë botuese.

2. Certifikimi i teksteve. Përpara se të shpërndahen ose të dalin për shitje, tekstet duhet të jenë të certifikuar me certifikatën e lejes për t’u futur në tregun e shitjes, si dhe të pajisura me pullën me hologram nga MASH-i. Pullat me hologram u shiten botuesve kundrejt kostos së blerjes nga MASH-i.

3. Të ardhurat e realizuara nga shitja e pullës me hologram derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

I. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore për tekstet me përzgjedhje

1. Tekstet që do t’u shërbejnë shkollave për përzgjedhje. Çdo DAR/ZA, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.260, datë 18.4.2007 “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, është e detyruar t’i blejë botuesit përkatës 1(një) kopje të çdo titulli që ky i fundit i dërgon për përzgjedhje në shkollë (DAR/ZA), sipas listës, dërguar me urdhrin nr.245, datë 2.6.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e paketës së përzgjedhjes dhe të porosisë së teksteve shkollore “Altertekst 2008”. “Blerja e kopjeve për përzgjedhje të teksteve shkollore bëhet me fondet e Buxhetit të Shtetit të vitit korent, fondet buxhetore të detajuara në kapitullin 1, artikulli 602. Këto libra konsiderohen pronë e shkollës dhe inventarizohen dhe ruhen në bibliotekën e shkollës.

2. Detajimi i fondeve buxhetore. Për blerjen e teksteve që do të shërbejnë në shkolla për përzgjedhje, çdo DAR/ZA është e detyruar të dërgojë në MASH, brenda afatit të caktuar, pasqyrën përmbledhëse me të dhënat për numrin e titujve, sasinë e teksteve, si dhe fondet e nevojshme për likuidimin e detyrimeve ndaj botuesit. Këto të dhëna dërgohen sipas formularit të përcaktuar nga MASH-i (formulari nr.1). Pas marrjes së pasqyrave përmbledhëse, për tekstet për përzgjedhje MASH-i detajon fondet buxhetore dhe bën çeljen e fondeve të tyre të detajuara për çdo DAR/ZA “Për arsimin bazë” në gr.11, titulli 09120, kapitulli 1, artikulli 602, si dhe “Për arsimin e mesëm” në gr.11, titulli 09120, kapitulli 1, artikulli 602.

3. Likuidimi i detyrimeve ndaj botuesve. Të gjitha DAR/ZA-të, pasi shqyrtojnë për çdo rast dokumentacionin ligjor të nevojshëm për tekstet me përzgjedhje, sipas listës dërguar me urdhrin nr.245, datë 2.6.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e paketës së përzgjedhjes dhe të porosisë së teksteve shkollore “Altertekst 2008” faturave tatimore, procesverbalit/aktmarrjes në

dorëzim, si dhe fletëhyrjes në magazinë, urdhërojnë kryerjen e pagesës për likuidimin e detyrimeve ndaj botuesve.

II. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore për tekstet shkollore të arsimit bazë dhe të mesëm të përgjithshëm

1. Porosia e teksteve të botuesit për vitin shkollor 2007-2008. Çdo drejtor shkolle, me anë të një kërkesëporosie, bën porosinë të botuesit për tekstet e nxënësve të shkollës dhe një kopje e kësaj kërkesëporosie i dërgohet DAR/ZA-së. Në këtë kërkesëporosi parashikohet sasia e teksteve për çdo titull nga titujt e përzgjedhur të cilët figurojnë në katalogun e dërguar nga MASH-i. Porosia për tekste duhet të përfshijë/parashikojë të gjithë nxënësit e arsimit bazë dhe nxënësit e shkollave të mesme të përgjithshme.

2. Shtëpitë botuese i shesin tekstet e certifikuar në mjediset shkollore. Drejtorët e shkollave detyrohen t'u ofrojnë mjedise shtëpive botuese për shitjen e teksteve, sipas hartës së përcaktuar nga MASH-i. Në qytete të cilat kanë librari, shitja e teksteve mund të bëhet dhe në librari vetëm pas plotësimit të nevojave të shkollës. Çmimi i shitjes duhet të jetë jo më i lartë sesa çmimi, me të cilin janë paraqitur për miratim tekstet e certifikuar.

3. Botuesit/librashitësit të cilët i shesin tekstet shkollore me lekë në dorë, duhet t'i lëshojnë blerësit/nxënësit apo prindit dokumentin e shitjes, faturën tatimore sipas formularit E-TBV 055/a dhe formularit E-TVS 055/a të miratuara nga Ministri i Financave.

3.1 Librashitësit e autorizuar prej botuesve me kontratë, të cilët i shesin tekstet shkollore me lekë në dorë, duhet t'i lëshojnë blerësit nxënësit apo prindërit dokumentin e shitjes, faturën tatimore sipas formularit E-TBV 055/a dhe formularit E-TVS 055/a, të miratuara nga Ministri i Financave.

3.2 Botuesit, për tekstet shkollore që shesin drejtpërdrejt në shkollë/nxënësve ose nëpërmjet nënkontraktorëve/librashitësve, duhet që brenda datës 5.9.2008 të raportojnë në MASH për tekstet e shitura në gjithë vendin.

4. Nxënësit pas blerjes së teksteve dorëzojnë në drejtorinë e shkollës faturat tatimore të blerjes. Drejtoria e shkollës brenda datës 30.9.2008 harton listat për çdo klasë dhe për gjithë shkollën dhe i dërgon në DAR/ZA (sipas formularit nr.2). DAR/ZA brenda datës 10.10.2008 i dërgon MASH kërkesën për fonde buxhetore, të detajuara sipas niveleve arsimore, për arsimin bazë gr.11, titulli 09120, kapitulli 1, artikulli 606.

5. Vlera e fondeve buxhetore e përcaktuar si kompensim “transfertë tek individët” do të përdoret nga nxënësit/përdoruesit/prindërit për të përballuar diferencën midis çmimit të shitjes së teksteve shkollore dhe masës së caktuar për t'u përdorur si kompensim “transfertë tek individët” nga Buxheti i Shtetit.

6. Për nxënësit në arsimin bazë, çmimi i blerjes së teksteve në arsimin 9-vjeçar mbulohet nga buxheti i MASH-it për vitin korent, në formën e “transfertës tek individët” në masën 50 (pesëdhjetë) për qind e tij (për efekt rumbullakimi, deri në plus/minus 5 (pesë) lekë për çdo copë tekst).

6.1 Për nxënësit e arsimit bazë, që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, paraplegjikë, tetraplegjikë, çmimi i blerjes së teksteve në arsimin bazë 9-vjeçar mbulohet nga buxheti i MASH-it, në formën e “transfertës tek individët” për vitin korent në masën 100 për qind të tij (për efekt rumbullakimi, deri në plus/minus 5 (pesë) lekë për çdo copë tekst).

7. Fondet e miratuara si “transfertë tek individët” për vitin 2008, MASH-i i bën çelje për llogari të drejtorive arsimore rajonale (DAR), zyrave arsimore (ZA) pranë degëve të thesarit në rrethe. DAR dhe ZA, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga MASH-i për çeljen e fondeve në artikullin “transfertë tek individët”, paraqesin pranë degëve të thesarit dokumentacionin justifikues, mbi bazën e të cilit bëjnë kalimin/xhirimin e fondeve të kompensimit në formën e “transfertës tek individët” për llogari të përfituesit nxënësit/prindërit në bankat e nivelit të dytë, si dhe në zyrat e postës shqiptare, sipas shkollave që kanë në juridiksion.

8. Raportimi i fondeve nga DAR dhe ZA. DAR/ZA në fund të çdo muaji mbajnë aktrakordimi me bankat e nivelit të dytë, si dhe me zyrat e Postës Shqiptare, për gjendjen faktike të përdorimit të fondeve buxhetore “transfertës tek individët” të kaluara për llogari të përfituesit nxënësit/prindët dhe këtë situatë e raportojnë në MASH.

9. Fondet buxhetore “transferta tek individët”, gjenden në bankat e nivelit të dytë ose në zyrat e Postës Shqiptare dhe të patërhequra nga nxënësit/prindërit/përfituesit, deri në datën 31.12.2008, pas aktrakordimeve midis DAR/ZA dhe bankave të nivelit të dytë e zyrave të Postës Shqiptare, rikthehen nga këto të fundit dhe derdhen në Buxhetin e Shtetit.

III. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore, për tekstet shkollore të pakicave kombëtare

1. Porosia e teksteve të pakicave kombëtare. Çdo drejtor shkolle, me anë të një kërkesëporosie, bën porosinë të botuesit për tekstet e nxënësve të shkollës dhe një kopje e kësaj kërkesëporosie i dërgohet DAR/ZA. Në këtë kërkesëporosi parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur të cilët figurojnë në katalogun e dërguar nga MASH. Porosia për tekste duhet të përfshijë/parashikojë të gjithë nxënësit në shkollat e arsimit parauniversitar e specifikuar për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare.

2. Dorëzimi i teksteve të porositura. Për tekstet e pakicave kombëtare çdo porosi i dërgohet DAR/ZA. Në këtë kërkesëporosi parashikohet sasia e teksteve për çdo titull nga titujt e përzgjedhur të cilët figurojnë në katalogun e dërguar nga MASH, me urdhrin nr.245, datë 2.6.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e paketës së përzgjedhjes dhe të porosisë së teksteve shkollore Altertekst 2008”.

3. Shitja e teksteve të pakicave kombëtare bëhet kundrejt faturave tatimore të lëshuara nga botuesit. Faturat/çmimi i teksteve paguhet me pjesën e kontributit të nxënësit, si dhe masën e caktuar për blerjen e teksteve “transferts tek individët” përmes llogarive buxhetore të DAR/ZA-ve në formën e “transferts tek individët” në masën 99 (nëntëdhjetë e nëntë) për qind të tij.

4. Për nxënësit e familjeve të pakicave kombëtare të arsimit bazë, çmimi i shitjes së çdo titulli mbulohet nga buxheti i miratuar për MASH për vitin korent në formën e “transferts tek individët” në masën 99 (nëntëdhjetë e nëntë) për qind të tij.

5. Arkëtimet e bëra nga shitja e teksteve të pakicave kombëtare do të derdhen nga çdo DAR dhe ZA, në llogarinë e thesarit të rrethit “Mjete në ruajtje, nga të ardhurat nga shitja e teksteve shkollore për vitin shkollor 2008”. Të ardhurat e arkëtuara në këtë llogari, do të përdoren 100% nga DAR/ZA për likuidimin e botuesve furnizues për vitin 2008.

6. Për efekte të likuidimit të detyrimeve ndaj botuesve për tekstet e pakicave kombëtare, çdo DAR/ZA, për çdo parti tekstesh të furnizuara sipas faturës tatimore të furnizimit, hartohen aktet e pranimit dhe dokumentacioni i blerjes së teksteve nga nxënësit. Mbi këtë bazë DAR apo ZA-të urdhërojnë pagesën për likuidimin e detyrimeve ndaj botuesve, për arsimin bazë gr.11, titulli 09120, kapitulli 1, artikulli 606.

7. Degët e thesarit në rrethe, për likuidimin e teksteve për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare dhe nxënësit e shkollave profesionale, pasi shqyrtojnë për çdo rast dokumentacionin ligjor të nevojshëm të paraqitur nga DAR/ZA, urdhërojnë kryerjen e pagesës për botuesit në degën përkatëse të bankës.

IV. Të përgjithshme

1. Tekstet shkollore që blihen në tregun e lirë pa faturë tatimore sipas formularit E-TBV 055/a dhe formularit E-TVS 055/a, të miratuara nga Ministri i Financave, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, prindi apo nxënësi, drejtorja e shkollës nuk mbështeten me fonde nga Buxheti i Shtetit.

2. Tekstet shkollore që tregtohen pa pullën e certifikimit, i nënshtrohen procesit të konfiskimit në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Të gjitha tekstet shkollore që janë gjendje në magazinat e DAR dhe ZA, si dhe kanë vlerë përdorimi, të shiten me çmimet e miratuara për vitin shkollor 2006-2007. Nxënësit/prindërit duhet të paguajnë 50% të çmimit të miratuar të shitjes së teksteve. Të ardhurat që do të rezultojnë nga shitja e teksteve gjendje në magazinë do të derdhen nga çdo DAR dhe ZA për llogari të:

- degës së thesarit Tiranë

- aparatit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

- në llogarinë 466 “Mjete në ruajtje, të ardhura nga shitja e teksteve shkollore, për vitin shkollor 2008”, për likuidimin e detyrimeve të trashëguara.

4. Raportimi i fondeve të subvencionit buxhetor nga DAR dhe ZA. DAR/ZA në fund të çdo muaji raportojnë në MASH për gjendjen faktike të përdorimit të fondeve të subvencionit buxhetor të kaluara për llogari të përfituesve nxënësve/prindërve, si dhe likuidimin e detyrimeve ndaj botuesve.

B. Për tekstet e arsimit universitar

1. Shtypja dhe shpërndarja e teksteve të arsimit universitar organizohet dhe drejtohet nga

Shtëpia Botuese e Librit Universitar, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.266, datë 22.5.1995 “Për subvencionimin e një pjese të çmimeve të botimeve të Shtëpisë Botuese të Librit Universitar.

2. Kostoja e shtypjes së çdo titulli të arsimit universitar mbulohet deri në masën 40% të saj nga subvencioni i dhënë për vitin korent, por pa kaluar në total shumën vjetore të miratuar për këtë qëllim.

3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, brenda kuotave të miratuara në buxhetin e vitit korent, përcakton masën e kostos, që do të mbulohet nga subvencioni për çdo titull të teksteve universitare, gjithnjë mbi bazën e dokumentacionit justifikues, situacionin dhe faturat e përgatitura nga Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.25, datë 7.9.2007 “Për procedurat e përdorimit të subvencionit nga Buxheti i Shtetit për shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”, i ndryshuar, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.25/1, datë 10.12.2007 “Për procedurat e përdorimit të subvencionit nga Buxheti i Shtetit për shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

KËRKESË PËR MBËSHTETJE ME FONDE BUXHETORE PËR TEKSTET SHKOLLORE
PËR PËRZGJEDHJE

Formulari nr.1, arsimit bazë, titulli 09120

Nr.	Emërtimi	Numri i titujve të teksteve të furnizuara	Numri i teksteve të furnizuara/copë	Vlera totale e detyrimeve në lekë
1.	Shtëpia Botuese “Hëna” p.sh.	3	360	90.000
2.	Shtëpia Botuese “Dielli” p.sh.	5	520	130.000
3.	...			
	Totali i detyrimeve për vitin 2007	8	880	220.000

Formulari nr.1, arsimi i mesëm i përgjithshëm, titulli 09230

Nr.	Emërtimi	Numri i titujve të teksteve të furnizuara	Numri i teksteve të furnizuara/copë	Vlera totale e detyrimeve në lekë
1.	Shtëpia Botuese “Hëna” p.sh.	2	120	30.000
2.	Shtëpia Botuese “Dielli” p.sh.	3	180	45.000
3.	...etj			
	Totali i detyrimeve për vitin 2007	5	300	75.000

Formulari nr.1, arsimi profesional, titulli 09240

Nr.	Emërtimi	Numri i titujve të teksteve të furnizuara	Numri i teksteve të furnizuara/copë	Vlera totale e detyrimeve në lekë
1.	Shtëpia Botuese “Afërdita” p.sh.	1	50	15 000
2.	Shtëpia Botuese “Dielli” p.sh.	5	260	65 000
3.	... etj			
	Totali i detyrimeve për vitin 2007	6	310	80 000

Kërkesë për mbështetje me fonde buxhetore “transfertë tek individët”, për nxënësit, përfituesit, blerësit

Formulari nr.2 për arsimin bazë, titulli 09120

Nr.	Emri,mbiemri/nxënësit/prindërit	Emri i shkollës	Klasa 1-9 të	Fatura nr.datë	Numri i teksteve të blera/copë	Shuma e paguar nga prind/nxënësi në lekë	Shuma për t’u paguar si transf individët në 50% në lekë	Numri i llogarisë bankare/ose zyra e postës shqiptare ku do të paguhet “transfertë tek individë”	Dokumenti i identitetit për prindin që tërheq “transfertë” tek individë”	Nënshkrimi për prindin që tërheq “transfertë tek individë”
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ermal Dritan Peto	Delvinë	I-rë	15/1.9.2008	5	1700	850	Zyra Postare Delvinë	Plotësohet ditën kur tërhiqen lekët	Plotësohet ditën kur tërhiqen lekët
2	Denisa Paskal Naqe	Delvinë	I-rë	26/3.9.08	5	1700	850	Zyra Postare Delvinë		
...		Delvinë	I-rë	x	x	X	x	Zyra Postare Delvinë		
25.	Orion Sokol Vrap	Delvinë	I-rë	8/02.9.08	5	1700	850	Zyra Postare Delvinë		
	Totali					42,500	21,250			

UDHËZIM
Nr.4, datë 12.9.2008

PËR MBAJTJEN E KADASTRËS SË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 16 pika 8 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Kadastra ndërtohet dhe funksionon në përputhje me kriteret teknike që përdoren për evidentimin dhe regjistrimin fillestar të pyjeve dhe kullotave; të të dhënave për mbajtjen dhe pasqyrimin e ndryshimeve periodike që pëson fondi pyjor dhe kulllosor kombëtar, nëpërmjet Sistemit të Informimit Gjeografik (GIS).

2. Kadastra e fondit pyjor dhe kulllosor është unike, e organizuar në dy nivele:

- a) Kadastra e nivelit qendror, e cila mbahet dhe administrohet nga ministria;
- b) Kadastrat e nivelit lokal, të cilat mbahen dhe administrohen nga drejtoritë e shërbimit pyjor;
- c) Kadastrat e nivelit lokal janë pjesë e sistemit të kadastrës kombëtare, varen dhe veprojnë nën drejtimin e saj.

3. Kadastra e fondit pyjor dhe kulllosor kombëtar mban dhe përditëson, në të gjitha nivelet e administrimit:

- a) gjendjen e fondit pyjor për treguesit kryesorë silvoteknikë, sipas pronësisë dhe përdorimit;
- b) gjendjen e fondit kulllosor, në sipërfaqe dhe kapacitet mbajtës, sipas pronësisë dhe përdorimit;
- c) nivelin e menaxhimit të këtij fondi, nëpërmjet informimit të shpejtë në hapësirë dhe kohë mbi gjendjen dhe mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm të tij.

4. Të dhënat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme nga drejtoritë e shërbimit pyjor dhe strukturat përgjegjëse në njësitë e qeverisjes vendore, që kanë në pronësi apo përdorim pyje dhe kullota, nëpërmjet Sistemit të Informimit Gjeografik (GIS), duke krijuar bazën e të dhënave siç përcaktohet në këtë udhëzim.

5. Plani i mbarështimit/inventarizimit është baza e të dhënave për treguesit e fondit pyjor dhe kulllosor kombëtar.

6. Sipas udhëzimit nr.1, datë 28.3.2001 “Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve”, miratuar nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave, ndarjet në ngastra dhe nënngastra shërbejnë:

- a) si njësi bazë për orientimin, organizimin, planifikimin e mbarështimit të pyllit dhe kullotës;
- b) për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe zbatimin e trajtimeve silvikulturale në sipërfaqe jo me të vogël se 0,5 ha.

7. Gjatë procesit të vlerësimit të grumbujve pyjorë, në kadastrën e pyjeve dhe kullotave pasqyrohet pronësia dhe përdorimi i tokës sipas përkatësisë, publik ose privat.

8. Në kadastrën e nivelit qendror të fondit pyjor dhe kulllosor:

- a) krijohet baza e të dhënave hapësimore, që lejon kryerjen e një analize gjeografike të pyjeve dhe kullotave shtetërore, komunale dhe private.
- b) baza e të dhënave ruhet në pasqyra (tabela) me një identifikim (kod) specifik për secilin numër pronësie (ngastra/nënngastra), i cili shërben si pikë lidhjeje për kryerjen e veprimeve.

9. Kadastra e pyjeve dhe kullotave në drejtoritë e shërbimit pyjor pajiset me harta tematike të dixhitalizuara në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.1, datë 28.3.2001 “Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve” nga Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor dhe Kulllosor, por të pagjeoreferuara, të cilat janë:

- a) harta e sipërfaqeve provë të përhershme e të përkohshme;
- b) harta e funksioneve dhe sistemeve të mbarështimit;
- c) harta e tipeve të grumbullit;
- d) harta e masave silvikulturale, prioritetet e tyre.

10. Si bazë për përpilimin e hartave shërbejnë hartat topografike të shkallës 1 : 25000 të

përgatitura nga Instituti i Topografisë Ushtarake, të skanuara dhe të gjeoreferuara, duke përdorur sistemin koordinativ të bazës gjeografike të të dhënave që mbështetet në projeksionet konike Lambert dhe koordinatat WGS 84. Koordinatat e ruajtura mund të transformohen në koordinata lokale drejtkëndëshe nëpërmjet përdorimit të GIS në kohë reale, duke i dhënë mundësi përdoruesit që të punojë në sistemet drejtkëndëshe, me qëllim shmangien e thyerjeve dhe të objekteve gjeografike të tepërta.

11. Paraqitja hartografike në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave bëhet sipas formave të pronësisë apo përdorimit të fondit pyjor dhe kullor. Drejtoritë e Shërbimit Pyjor dixhitalizojnë me poligone të mbyllur shtresat e mëposhtme:

a) kufijtë e ekonomive pyjore, pjesëve ekonomike, ngastrave dhe nënngastrave, mbështetur në hartat e planeve të mbarështrimit dhe inventarizimit;

b) kufijtë e qarqeve, rretheve dhe njërive të qeverisjes vendore (NJQV), mbështetur në harta institucionalisht të njohura:

c) kufijtë e pronave private, fond pyjor dhe kullor.

12. Informacioni i pikës 11 të këtij udhëzimi dërgohet në kadastrën qendrore, e cila kontrollon që të mos ketë mbivendosje, kufij të tepërt ose zona konfliktuale, dhe plotëson në nivel kombëtar të gjitha të dhënat e mësipërme.

13. Për të realizuar harta tematike, statistika, analiza etj., janë të nevojshme këto shtresa:

a) rrjeti hidrografik, një shtresë e tipit linjë, shënuar me blu të errët;

b) rrjeti rrugor, një shtresë e tipit linjë, shënuar me kafe të errët;

c) kufijtë e qarqeve, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të kuqe, 1 mm të trashë;

d) kufijtë e rretheve, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të kuqe, 0.75 mm të trashë;

e) kufijtë e komunave/bashkive, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të kuqe 0.5 mm të trashë;

f) kufijtë e ekonomive pyjore, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të zezë, 1 mm të trashë;

g) kufijtë e pjesëve ekonomike, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të zezë, 0.75 mm të trashë;

h) kufijtë e ngastrave, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të zezë, 0.5 mm të trashë;

i) kufijtë e nënngastrave, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të zezë, 0.25 mm të trashë;

j) ndarjet pronësore, një shtresë e tipit poligon, shënuar me të kuqe 0.25 mm të trashë;

k) koordinatat dhe diametrat e sipërfaqeve provë të përhershme, një shtresë e tipit pikë me ngjyrë të kuqe;

l) koordinatat dhe diametrat e sipërfaqeve provë të përkohshme, një shtresë e tipit pikë me ngjyrë të verdhë;

m) qendrat e banuara, një shtresë e tipit pikë me ngjyrë të zezë ose poligon në vartësi të madhësisë së qendrës;

n) linjat e konturit (lartësisë).

14. Çdo shtresë e mësipërme duhet të jetë e përfunduar pa gabime, me saktësi të pranuar në dixhitalizim 0,02–0,05. Elementet e secilës shtresë duhet të jenë të identifikuara në mënyrë të vetme, në mënyrë që të realizohet lidhja me atributet.

15. Për të eliminuar mbivendosjen e kufijve gjatë dixhitalizimit, veprohet si vijon:

a) dixhitalizimi i rrjetit hidrografik;

b) dixhitalizimi i rrjetit rrugor;

c) dixhitalizimi i kufijve të qarqeve;

d) dixhitalizimi i kufijve të rretheve;

e) dixhitalizimi i kufijve të komunave/bashkive;

f) dixhitalizimi i ngastrave;

g) dixhitalizimi i nënngastrave;

h) vendosja e qendrave të sipërfaqeve provë të përhershme;

i) vendosja e qendrave të sipërfaqeve provë të përkohshme;

- j) vendosja e attributeve për secilën shtresë.
16. Formati dixhital të jetë *ArcInfo Coverage*.
17. Pasqyra e të dhënave të nënngastrës në aspektin hartografik përmban:
- informacionin, nëse grumbulli pyjor është historik ose aktiv;
 - qarkun;
 - rrethin;
 - ekonominë pyjore;
 - pjesën ekonomike;
 - ngastrën;
 - nënngastrën;
 - ndarjet sipas formave të pronësisë;
 - ndarjet sipas formës së administrimit;
 - ndarjet sipas përdoruesve;
 - sipërfaqen.
18. Dokumentacion i detyrueshëm kadastral konsiderohen hartat tematike të përbëra nga:
- harta e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme,
 - harta e funksioneve dhe sistemeve të mbarështimit;
 - harta e tipeve të grumbullit;
 - harta e masave silvikulturale, prioritetet e tyre;
 - harta e pronësisë, e përdoruesve dhe formës së administrimit.
19. Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të hartuara për çdo ekonomi pyjore në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.1, datë 28.03.2001 “Për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve”, përbëjnë bazën e mbajtjes së treguesve kadastralë për gjendjen e fondit pyjor dhe kullor.
20. Grupi i parë i treguesve kadastralë janë të dhënat identifikuese si vijon:
- qarku;
 - rrethi;
 - NJQV;
 - ekonomia pyjore;
 - pjesa ekonomike;
 - ngastrë;
 - nënngastrë;
 - përdorimi i territorit, i klasifikuar sipas këtyre kategorive: pyll, bujqësore, kullotë, livadh, djerrë, urbane, sipërfaqe ujore, kënetë/moçal, pyje të hapur, tokë me bimësi pyjore, sipërfaqe joprodhuese:
 - pronësia;
 - administrimi;
 - përdoruesi.
21. Grupi i dytë i treguesve kadastralë është përshkrimi i gjendjes së grumbullit pyjor si vijon:
- formacion bimor drurë, shkurre;
 - forma e qeverimit të grumbullit pyjor, sipas këtij klasifikimi: trungishte, cungishte, trungishte e përbërë, cungishte e përbërë, shkurre;
 - funksioni kryesor: prodhues, pyje që kulloten dhe krasiten, mbrojtës, mbrojtjes+ prodhues, konservues, rekreacion;
 - faza e zhvillimit:
 - d.1 për trungishtet: filizëri, gëmushaj, lëmishte, imshtaj e re, imshtaj e moçme, trungishte e re, trungishte e mesme, trungishte e moçme;
 - d.2 për cungishtet dhe shkurret: e rinisë, e parapjekurisë, e pjekurisë, e pleqërisë;
 - tipi i pyllit;
 - kati: njëkatësh, dykatësh, shumëkatësh.
22. Grupi i tretë janë treguesit që dalin nga inventarizimi i grumbullit pyjorë në sipërfaqet

provë 200 x 200 m në rrjet kuadratik, për vlerësimin sasior dhe cilësorë të tyre, si vijon:

- a) kurorëndësia (kd);
- b) trundendësia (td), rritja vijuese (Rv);
- c) rritja mesatare vjetore (Rmv);
- d) vëllimi për ha dhe në total.

23. Matjet e diametrave të drurëve dhe shkurreve sipas formës së qeverimit fillojnë:

- a) për trungishtet 10 cm e lart;
- b) për cungishtet sipas grupeve diametrike 6 – 9 cm dhe, 10 cm e lart;
- c) për shkurret 4 cm e lart.

24. Të dhënat për vëllimin total dhe sipas asortimenteve të grumbujve pyjor përpunohen në programin *Microsoft Acces*, i cili është pjesë e Kadastrës Kombëtare të Fondit Pyjor dhe Kullësor, duke evidentuar: lartësinë mesatare (hm), diametrin mesatar (dm), lartësinë zotëruese (hz), moshën mesatare (Mm), klasën e prodhimit (klp) dhe jepen sipas:

- a) funksionit kryesor;
- b) tipit të pyllit;
- c) formës së qeverimit të grumbullit;
- d) llojeve përbërëse sipas katit dhe formës së qeverimit;
- e) klasave të moshës sipas llojeve përbërës, katit dhe formës së qeverimit;
- f) klasave diametrike, sipas llojeve përbërës dhe formës së qeverimit;
- g) klasave të prodhimit,

duke marrë në konsideratë gabimin standard (E%) vetëm për pikat a, b dhe c.

25. Dokumentacioni i lartpërmendur i tipit kartelë në nivel nënngastre, (ngastre) është pjesë e arkivit së kadastrës pyjore, dhe ruhet sipas normave në fuqi.

Treguesit kadastralë të detyrueshëm për t'u mbajtur nga kadastra pyjore mbi bazën e informacionit të lartpërmendur, jepen në aneksin 1.

26. Në rastet kur inventarizimet pyjore kombëtare dhe rajonale bëhen të pavarura nga inventarizimet në nivel ekonomie pyjore, ngastrash ose grup ngastrash, dhe informacioni që rrjedh nga këto nivele është i ndryshëm, kadastra pyjore bën integrimin vertikal të informacionit sipas niveleve të ndryshme dhe krahasimin e rezultateve, duke bërë korrigjimet përkatëse. Si bazë kryesore të dhënash shërben informacioni që merret për nivelin më të ulët të organizimit të grumbujve pyjorë.

27. Si pjesë e dokumentacionit teknik arkivor për inventarizimin pyjor kombëtar dhe rajonal, kadastra mban edhe skedat origjinale të terrenit, të hedhura dhe në formë elektronike, të cilat përmbajnë:

- a) rilevuesin, datën dhe orën e rilevimit;
- b) të dhënat identifikuese të sipërfaqes provë;
- c) treguesit e grumbullit – funksioni kryesor, tipi i grumbullit, forma e qeverimit, klasa aktuale e moshës sipas katit dhe formës së qeverimit, tipi i sipërfaqes provë, të koduar;
- d) madhësinë e sipërfaqes provë, pjerrësinë, rrezën;
- e) azimutin dhe distancën për drurët me $d \geq 10$ cm;
- f) diametrin në 1,30 m sipas llojeve drusore, katit, formës së qeverimit, grupeve diametrike;
- g) lartësinë e drurit me diametër mesatar, sipas llojit, katit, formës së qeverimit;
- h) moshën, sipas llojeve drusore, katit, formës së qeverimit;
- i) lartësinë zotëruese;
- j) dëmtimet;
- k) cilësinë e drurit;
- l) infrastruktura e fondit pyjor (rrugë etj.).

28. Kadastra pyjore, në periudhat ndërmjet dy inventarizimeve kombëtare dhe ndërmjet dy planeve të mbarështrimit, pasqyron ndryshimet që ndodhin në fondin pyjor për shkak të ndryshimeve në:

- a) pronësi, administrim, përdorim;
- b) gjendjen e grumbullit dhe treguesit silvoteknikë të tij.

Intervali i dhënies së informacionit të përditësuar përdoruesve varet nga intervali i përditësimit të të dhënave qendrore. Me përjashtim të aspekteve të pronësisë, administrimit dhe përdoruesve, të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, ndryshimet e gjendjes së grumbullit evidentohen në një interval kohor më të gjatë. Të dhënat për diametrin, lartësinë, tipin e pyllit etj.,

përditësohen në planet e mbarështimit.

29. Heqja e sipërfaqeve të regjistruara në zërin kadastral pyll bëhet për shkak të ndryshimit të destinacionit të sipërfaqes pyjore në kategori të tjera të përdorimit të territorit.

30. Sipërfaqet që pakësohen nga dështimet në pyllëzime, rënia e zjarreve apo e faktorëve të tjerë atmosferikë e njerëzor mbeten fond pyjor, por kalojnë në zërin tokë me bimësi pyjore ose djerrë kur këto sipërfaqe nuk mund të ripërtërihen në mënyrë natyrale.

31. Nuk hiqen nga fondi pyjor dhe konsiderohen pjesë e tij korridoret me gjerësi deri në 10 m të hapura për mbrojtjen nga zjarri, linja tensioni dhe hapje rrugësh me gjerësi nën 10 m përfshirë dhe bankinën, çeltirat që krijohen brenda grumbullit nga shpimet, gërmimet, apo ndërtimet e veçuara sipërfaqja e të cilave nuk kalon 0,1 ha dhe në total nuk kalojnë 5 % të sipërfaqes së nënparcelës.

32. Për ndryshimet e destinacionit të përdorimit të fondit pyjor dhe kullësor hartohen raporte teknike përkatëse, me skicë dhe kufij të rregullt, duke përdorur GPS për identifikimin e koordinatave. Skica e ngastrës jepet e gjeoreferuar nëpërmjet koordinatave të përcaktuara, e cila duhet të përmbajë të gjitha detajet, si lumenjtë, rrugët etj.

33. Ndryshimet në sipërfaqen e fondit pyjor pasqyrohen sipas zërave kadastralë. Në rast se pyllëzimi bëhet në sipërfaqe të mbuluara me shkurre ose pyje të degraduar, por që $kd > 0.3$, sipërfaqja pyjore e fondit pyjor nuk ndryshon. Në këtë rast ndryshon tipi i pyllit dhe pakësohet lloji shkurre apo i pyllit të degraduar ose me prodhimtari të ulët dhe shtohet sipërfaqja e llojit me të cilin është pyllëzuar.

34. Shtesat në vëllim pasqyrohen nga rritja vijuese e drurëve; rivlerësimi i pyjeve të rinj, të cilët plani i mbarështimit i ka vlerësuar pa vëllim; evidentimi i sipërfaqeve që nuk janë pasqyruar më parë në planet e mbarështimit; dhe nga ndryshimet në madhësinë e sipërfaqes së nënngastrës.

35. Shtesat nga rritja vijuese bëhen në fund të vitit sipas programit kompjuterik të hartuar për këtë qëllim, duke shumëzuar trungdendësinë që jepet në planet e mbarështimit me rritjen vijuese të tabelave për llojin përkatës, formula e llogaritjes është: $(Rt = Td \times Rv/ha \times S)$.

36. Rivlerësimi i pyjeve të rinj, që plani i mbarështimit i ka vlerësuar pa vëllim, dhe evidentimi i sipërfaqeve që nuk janë pasqyruar më parë në planet e mbarështimit, bëhet nëpërmjet inventarizimit me sipërfaqe provë të përhershme dhe të përkohshme, të dhënat e të cilave hidhen në programin kompjuterik.

37. Ndryshimet në vëllim, që vijnë nga shfrytëzimet, prerjet kulturore, regjistrohen sipas ekonomive pyjore dhe nënngastrave ku është bërë ndërhyrja, në kapitullin punime të kryera, duke dhënë sipërfaqen, numrin e drurëve dhe vëllimin në asortimente sipas llojeve dhe tipin e ndërhyrjes. Për prerjet e paligjshme jepet sipërfaqja, numri i drurëve të prerë dhe vëllimi në asortimente sipas llojeve.

38. Ndryshimet dhe shtesat e fondit pyjor në sipërfaqe dhe vëllim sipas pikave nga 29 deri në 37 të këtij udhëzimi, pasqyrohen vetëm pasi të jenë miratuar nga autoriteti publik përkatës.

39. Kartela për pasqyrimin e ndryshimeve periodike të fondit pyjor jepet në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

40. Dokumentacioni shkresor kadastral, duke përfshirë dhe atë topografik, mbahet në arkivin teknik dhe administrohet sipas dispozitave ligjore mbi përdorimin e arkivave teknike. Dokumentacioni i terrenit ruhet në gjendje të pastër dhe i plotë, duke u grupuar në dosje të veçanta në bazë ekonomie pyjore, komune, rrethi dhe qarku.

41. Informacioni i pikës 40 të këtij udhëzimi, mbahet në kompjuter në programin *Microsoft Acces*, të unifikuar për të mundësuar lidhjen automatike dhe përditësimin e tij, paraqitjen në GIS, me qëllim që të bëjë lidhjen e vazhdueshme me sistemet qendrore dhe produktet dixhitale e analoge për të plotësuar nevojat e përdoruesve të tjerë.

42. Fondi kullësor kombëtar kadastrohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”.

43. Baza topografike dhe kriteret e paraqitjes hartografike për fondin kullësor janë të njëjta me ato për fondin pyjor.

44. Për të eliminuar mbivendosjen e kufijve mes pyjeve dhe kullotave, dixhitalizimi i hartave do të jetë unik si për fondin pyjor, duke ndjekur të njëjtën rradhë pune për dixhitalizim.

45. Pasqyra e attributeve të nënngastrës të fondit kullosor në aspektin hartografik përmban:
- klasifikimin e informacionit në historik ose aktiv;
 - qarkun;
 - rrethin;
 - ekonominë kullosore;
 - pjesën ekonomike;
 - ngastrën;
 - nënngastrën;
 - ndarjet sipas pronësisë;
 - ndarjet sipas formës së administrimit;
 - ndarjet sipas përdoruesve;
 - sipërfaqen.
46. Dokumentacion i detyrueshëm kadastral konsiderohen hartat tematike të përbëra nga:
- harta e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme,
 - harta e tipeve të kullotës (verore, dimërore);
 - harta e masave që do të ndërmerren, prioritetet e tyre;
 - harta e pronësisë, e përdoruesve dhe e formës së administrimit.
47. Pasqyrimi i gjendjes së fondit kullosor bazohet në treguesit që jepen në planet përkatëse të mbarështrimit dhe inventarizimit të hartuar në nivel ekonomie kullosore.
48. Grupi i parë i attributeve janë të dhënat identifikuese.
49. Grupi i dytë janë të dhënat përshkruese e të gjendjes së kullotës sipas attributeve të mëposhtme:
- tipi i kullotës – kullotë, livadh, kullotë me drurë dhe shkurre;
 - periudha e përdorimit - dimërore, verore;
 - treguesi i dobishmërisë së territorit – jepet në % ndaj sipërfaqes totale;
 - përbërja floristike – jepet në përqindje sipas grupeve floristike graminore, bishtajore, të tjera, si dhe llojet kryesore përbërëse për çdo grup;
 - prodhimtaria – në kv/ha sipas grupeve floristike;
 - përbërja e llojeve drusore dhe shkurreve në përqindje;
 - shkalla e mbulimit në përqindje;
 - aftësia mbajtëse – jepet në krerë dhen, dhi, të trasha;
 - infrastruktura e kullotave (lerat, koritat, stane, lugjet, ngrehina, objekte përpunim qumështi etj.).
50. Treguesit kadastrale të detyrueshëm për t'u mbajtur nga kadastra kullosore mbi bazën e informacionit të lartpërmendur, jepen në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
51. Planet e mbarështrimit në format të shkruar dhe elektronik janë pjesë e dokumentacionit teknik arkivor të kadastrës së pyjeve dhe kullotave.
52. Kadastra kullosore, në periudhat ndërmjet dy inventarizimeve kombëtare dhe ndërmjet dy planeve të mbarështrimit, pasqyron ndryshimet që ndodhin në fondin kullosor për shkak të ndryshimeve në:
- pronësi, administrim, përdorim;
 - treguesit e gjendjes së kullotës.
53. Heqja e sipërfaqeve të regjistruara në zërin kadastral kullotë bëhet për shkak të ndryshimit të sipërfaqes kullosore në kategori të tjera të përdorimit të territorit.
54. Nuk hiqen nga fondi kullosor dhe konsiderohen pjesë e tij korridoret për linja transmetimi me gjerësi më të vogël 10 m dhe hapje rrugësh me gjerësi më të vogël se 5 m, përfshirë dhe bankinën, sheshet që krijohen brenda kullotës nga shpimet, gërmimet, apo ndërtimet e veçuara, sipërfaqja e të cilave nuk kalon 0,1 ha dhe në total nuk kalojnë 5 % të sipërfaqes së nënparcelës.
55. Për ndryshimet e destinacionit të përdorimit të fondit kullosor hartohen raporte teknike përkatëse me skicë dhe kufij të rregullt duke përdorur GPS për identifikimin e koordinatave.
56. Ndryshimet dhe shtesat e fondit kullosor në sipërfaqe dhe kapacitet kullosor pasqyrohen vetëm pasi të jenë miratuar nga autoriteti publik përkatës.
57. Shtesat e sipërfaqeve dhe të kapaciteteve kullosore, që nuk janë pasqyruar në planet e mbarështrimit, bëhen pas matjeve direkt në terren.

58. Në fondin kullosor pasqyrohen ndryshimet që ndodhin nga pakësimi i kapacitetit kullosor, i dëgjues së kullotës, i ndryshimit të përbërjes floristike etj.

59. Kartela për pasqyrimin e ndryshimeve periodike të fondit kullosor jepet në shtojcën 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

60. Informacioni mbahet në kompjuter në programin *Microsoft Acces* të unifikuar, për të mundësuar lidhjen automatike dhe përditësimin e tij, paraqitjen në GIS, me qëllim që të bëhet lidhja e vazhdueshme me sistemet qendrore dhe produktet dixhitale e analoge për të plotësuar nevojat e përdoruesve të tjerë.

61. Kadastra e nivelit qendror mban dhe përditëson të dhënat si më poshtë:

- a) bazën e të dhënave në nivel parcele;
- b) kufijtë nënparcele, parcelë, kufij ekonomie pyjore;
- c) kufijtë e komunës/bashkisë.

62. Kadastra e nivelit lokal mban dhe përditëson të dhënat si më poshtë:

- a) të dhënat për nënparcelat dhe parcelat, sipas ekonomive pyjore në administrim të ministrisë;
- b) të dhënat për nënparcelat dhe parcelat sipas pjesëve ekonomike në pronësi apo përdorim të njësisve të qeverisjes vendore;

Kadastrat në drejtoritë e shërbimit pyjor raportojnë në kadastrën qendrore 2 herë në vit brenda datave 30 qershor dhe 30 dhjetor, për ndryshimet që pëson fondi pyjor dhe kullosor.

63. Raportimi i treguesve kadastralë të fondit pyjor dhe kullosor bëhet sipas formularëve tip të shtojcave 1 deri 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

64. Praktikat dokumentare të Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave në nivel qendror dhe lokal regjistrohen në regjistrin e korrespondencës sipas modeleve në shtojcën 7 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

65. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave, si dhe drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

SHTOJCA 1

FONDI PYJOR: TREGUESIT KADASTRALË TË NËNPARCELËS/PARCELËS

1. Të dhënat identifikuese

Ndërtohet tabela etributeve sipas nivelit hierarkik të organizimit administrativ dhe të aspekteve të pronësisë sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*. Çdo nënparcelë/parcelë do të ketë një kod unik identifikimi.

2. Karakteristikat kryesore të grumbullit

Ndërtohet tabela etributeve me karakteristikat kryesore të grumbullit të dhëna në kapitullin 3.1.2 ndërtuar sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

3. Treguesit dendrometrikë sipas llojeve

Ndërtohet tabela etributeve me treguesit dendrometrikë, sipas llojeve, formës së qeverimit, klasave të moshës, sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*

SHTOJCA 2

FONDI PYJOR: NDRYSHIMET E KONSTATUARA SIPAS NËNPARCELËS, PARCELËS

1. Të dhënat identifikuese

Ndërtohet tabela etributeve sipas nivelit hierarkik të organizimit administrativ dhe të

aspekteve të pronësisë sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*. Çdo nënparcelë/parcelë do të ketë një kod unik identifikimi.

2. Karakteristikat kryesore të grumbullit

Ndërtohet tabela etributeve me karakteristikat kryesore të grumbullit, të dhëna në kapitullin

3.1.2, ndërtuar sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

3. Treguesit dendrometrikë sipas llojeve

Ndërtohet tabela etributeve me treguesit dendrometrikë, sipas llojeve, formës së qeverimit, klasave të moshës, sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

SHTOJCA 3

FONDI PYJOR: REZULTATET DHE RAPORTIMI

- Hierarkia e paraqitjes së rezultateve për treguesit kryesorë të grumbullit

- Pronësia

- Formacioni bimor

- Funksioni kryesor

- Forma e qeverimit të grumbullit

- Tipi i pyllit

- Origjina

- Lloji

- Forma e qeverimit

- Klasa e moshës

- Klasa e prodhimit

- Raportet:

Rap. 01: Përdorimi i territorit sipas pronësisë – jepet sipërfaqja sipas përdorimit të territorit.

Rap. 02: Të dhënat e treguesve kryesorë të grumbullit sipas pronësisë, funksionit, formës së qeverimit të grumbullit dhe tipit të pyllit – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 03: Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë sipas funksionit kryesor, formës së qeverimit, tipit të pyllit dhe origjinës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 04: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë sipas funksionit kryesor, formës së qeverimit, tipit të pyllit dhe origjinës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 05: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë sipas funksionit kryesor, formës së qeverimit, tipit të pyllit dhe origjinës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 06: Të dhënat për grumbujt pyjorë sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 07: Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë prodhues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 08: Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë mbrojtës sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 09: Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë konservues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 10: Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë rekreacion sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 11: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë prodhues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 12: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë mbrojtës sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 13: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë konservues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 14: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë rekreacion sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 07: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë prodhues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 08: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë mbrojtës sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 09: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë konservues sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

Rap. 10: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë rekreacion sipas tipit të pyllit, llojeve, formës së qeverimit dhe klasave të moshës – jepet sipërfaqja dhe vëllimi.

SHTOJCA 4

FONDI KULLOSOR: TREGUESIT KADASTRALË TË NËNPARCELËS/PARCELËS

1. Të dhënat identifikuese

Ndërtohet tabela e attributeve sipas nivelit hierarkik të organizimit administrativ dhe të aspekteve të pronësisë sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*. Çdo nënparcelë/parcelë do të ketë një kod unik identifikimi.

2. Karakteristikat kryesore të kullotës

Ndërtohet tabela e attributeve me karakteristikat kryesore të kullotës të dhëna në kapitullin 4.1.2 ndërtuar sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

3. Treguesit kullorosë sipas tipit të kullotës, sezonalitetit dhe përbërjes floristike

Ndërtohet tabela e attributeve me treguesit kullorosë sipas tipit të kullotës, sezonalitetit dhe përbërjes floristike, sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

SHTOJCA 5

FONDI KULLOSOR: NDRYSHIMET E KONSTATUARA SIPAS NËNPARCELËS/PARCELËS

1. Të dhënat identifikuese

Ndërtohet tabela e attributeve sipas nivelit hierarkik të organizimit administrativ dhe të aspekteve të pronësisë sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*. Çdo nënparcelë/parcelë do të ketë një kod unik identifikimi.

2. Karakteristikat kryesore të kullotës

Ndërtohet tabela e attributeve me karakteristikat kryesore të grumbullit të dhëna në kapitullin 4.1.2 ndërtuar sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

3. Treguesit kullorosë sipas tipit të kullotës, sezonalitetit dhe përbërjes floristike

Ndërtohet tabela e attributeve me treguesit kullorosë sipas sipas tipit të kullotës, sezonalitetit dhe përbërjes floristike sipas programit të ndërtuar në *Microsoft Acces*.

SHTOJCA 6

FONDI KULLOSOR: REZULTATET DHE RAPORTIMI

Hierarkia e paraqitjes së rezultateve për treguesit kryesorë të kullotës

- Pronësia

- Tipi i kullotës

- Periudha e përdorimit

- Përbërja floristike

Raportet:

Rap. 01: Përdorimi i territorit sipas pronësisë – jepet sipërfaqja sipas përdorimit të territorit

Rap. 02: Të dhënat e treguesve kryesorë të kullotave sipas pronësisë, tipit të kullotës dhe sezonalitetit – jepet sipërfaqja, prodhimtaria dhe aftësia mbajtëse.

Rap. 03 Të dhënat për grumbujt pyjorë shtetërorë sipas tipit të kullotës dhe sezonalitetit – jepet sipërfaqja, prodhimtaria dhe aftësia mbajtëse.

Rap. 04: Të dhënat për grumbujt pyjorë komunalë sipas tipit të kullotës dhe sezonalitetit – jepet sipërfaqja, prodhimtaria dhe aftësia mbajtëse.

Rap. 05: Të dhënat për grumbujt pyjorë privatë sipas tipit të kullotës dhe sezonalitetit – jepet sipërfaqja, prodhimtaria dhe aftësia mbajtëse.

SHTOJCA 7

REGJISTËR I KORRESPONDENCËS MODEL NR.1

Nr.	Data e dorëzimit apo	Dorëzuesi apo marrësi	Dokumente të hyra	Dokumente të dalë	Arkiv-dosje
-----	----------------------	-----------------------	-------------------	-------------------	-------------

	mbërritjes	Struktura	Firma	Subjekti dërgues	Nr... data	Kujt i dërgohet	Data	

Indeksi alfabetik i korrespondencës model nr.2

Lënda	Dërguesi apo sektori autori i dokumentit	Numri i plotë i regjistrit, model 1

Dorëzimi i dokumentit model nr. 3

Data	Numri i dokumentit	Emërtimi i dokumentit	Kujt i dërgohet	Nënshkrimi i dërguesit

UDHËZIM
Nr.355, datë 21.5.2008

**PËR ROLIN, FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË E SEKRETARËVE TË DHOMAVE TË
TREGTISË PHE INDUSTRIËS NË QARQE DHE TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
TË BASHKIMIT TË DHOMAVE TË TREGTISË DHE INDUSTRIËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, si dhe nenit 18, 19, 33 dhe 40 të ligjit nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”,

UDHËZOJ:

I. Roli i sekretarit të dhomës

Sekretari i dhomës në qark mbikëqyr veprimtarinë e dhomës dhe ushtron në mënyrë të vazhdueshme kompetencat që i jep ligji nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”.

II. Funkcionet dhe përgjegjësitë e sekretarit të dhomës

Sekretari i dhomës kontribuon në mënyrë aktive që veprimtaria e dhomës të zhvillohet në përputhje me interesat e anëtarësisë së saj, të cilat përcaktohen në programet vjetore të punës të dhomës, si dhe me interesat publike, të përcaktuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Sekretari i dhomës, në përmbushje të funksionit të tij, kryen këto detyra:

1. Ndjek respektimin e ligjit të dhomave, të ligjeve të tjera, të akteve nënligjore dhe të statutit të dhomës në vendimet e marra nga organet drejtuese të dhomës.

1.1. Në rast se vëren shkelje të ligjshmërisë në vendimet e marra nga organet e dhomës (Asambleja, Kryesia, Kryetari, Komisioni i Auditimit), njofton organin mbikëqyrës, i cili brenda 30 ditëve nga vënia në dijeni, u kërkon këtyre organeve rishikimin e vendimeve të marra ose sipas rastit marrjen e vendimeve për të cilat janë të detyruara sipas ligjit.

2. Merr pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe të Kryesisë pa të drejtë vote, ngre çështje për shqyrtim dhe siguron zbatimin e dispozitave të ligjit të dhomave dhe të statutit të dhomës që kanë të bëjnë me thirrjet e mbledhjes, organizimin dhe vlefshmërinë e mbledhjes, arritjen e kuorumit dhe vendimmarrjes.

2.1. Sekretari i dhomës shtron çështje në Kryesi dhe në Asamble dhe këto të fundit i shqyrtojnë dhe shprehen me vendim (miratim ose refuzim) për çështjet e ngritura.

2.2. Sekretari i dhomës siglon procesverbalin e mbledhjes dhe vendimet e zbardhura duke u siguruar që këto dokumente janë në përputhje me vullnetin e shprehur të vendimmarrësve.

3. Ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë dhe Kryesisë nga subjektet e ngarkuara për zbatimin e tyre. Në çdo kohë, sekretari i dhomës informohet mbi statusin e zbatimit të vendimeve nga organet e ngarkuara për zbatimin e tyre dhe në rast se vëren moszbatim apo mosrespektim të këtyre

vendimeve informon me shkrim organin që ka marrë vendimin dhe organin mbikëqyrës.

3.1. Kryetari dhe administrata e dhomës bashkëpunon me sekretarin e dhomës në çdo kohë për kryerjen e detyrave në zbatim të vendimeve të organeve të dhomës.

4. Ndjek procedurat e regjistrimit të anëtarësisë në dhomë dhe siguron që regjistrimet në dhomë të kryehen në përputhje me procedurat dhe kuotat e aprovuara nga Asambleja e dhomës.

5. Sekretari dhomës ndjek zbatueshmërinë e ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi në procedurat e ndjekura nga dhoma për pajisjen e biznesmenëve me pasaporta shërbimi.

6. Sekretari i dhomës, kur e gjykon të nevojshme për çështje të caktuara, mund të kërkojë ushtrimin e kontrollit tematik nga Komisioni i Auditimit.

7. Sekretari i dhomës, në zbatim të ligjit të dhomave dhe të akteve nënligjore në fuqi, organizon procesin e zgjedhjeve të organeve drejtuese të dhomës.

8. Në rast se vëren shkelje të ligjit të dhomës, të akteve nënligjore, të ligjeve të tjera në fuqi dhe të statutit nga organet drejtuese të dhomës, pasi të ketë marrë mendimin e organin mbikëqyrës, sekretari i dhomës i propozon Asamblesë shkarkimin e tyre. Humbja e mandatit, deklarohet me vendim të Asamblesë.

9. Në rast se organet ekzekutive të dhomës vërejnë shkelje të ligjit të dhomës, të akteve nënligjore, të ligjeve të tjera në fuqi dhe të statutit nga sekretari i dhomës, njoftojnë Asamblenë, e cila me vendim të saj të arsyetuar i propozon organit mbikëqyrës shkarkimin e tij. Sekretari i dhomës shkarkohet me urdher të organit mbikëqyrës.

10. Njofton periodikisht organin mbikëqyrës për veprimtarinë e dhomës sipas udhëzimit të METE nr.953, datë 11.12.2007 “Për procedurat dhe përmbajtjen e raportimit periodik të dhomave të tregtisë dhe industrisë dhe bashkimit të dhomave të tregtisë dhe industrisë pranë organit mbikëqyrës”.

11. Me kërkesë të Asamblesë, Kryesisë apo Kryetarit, sekretari i dhomës është i detyruar të kontribuojë duke dhënë mendimin e tij për hartimin e planit vjetor të punës, buxhetit apo mbi çdo lloj vendimmarrje në interes të anëtarësisë së dhomës.

III. Roli, funksionet dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë

Sekretari Përgjithshëm i Bashkimit të Dhomave ka të njëjtin rol, përgjegjësi dhe detyra si sekretari i dhomës sipas pikës I dhe II të këtij udhëzimi, brenda sferës së veprimtarisë së Bashkimit të Dhomave. Përveç detyrave të mësipërme, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkimit të Dhomave ushtron edhe këto detyra:

1. Kur e çmon të arsyeshme, ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e kryesisë së Bashkimit të Dhomave.

2. Me kërkesë të organit mbikëqyrës udhëzon sekretarët e dhomave në qarqe për çështje që lidhen me veprimtari në interes të përbashkët të dhomave.

IV. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.671, datë 12.9.2008

**PËR REALIZIMIN DHE PARAQITJEN E KONTRATAVE TË SIGURIMIT, PËR
SIGURIMIN E PUNONJËSVE TË PUNËSUAR NË VEPRIMTARINË MINERARE NGA
AKSIDENTET NË PUNË**

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”,

UDHËZOJ:

1. Të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, detyrohen të sigurojnë pranë një shoqërie sigurimi, punonjësit e tyre nga aksidentet në punë sipas një kontrate sigurimi, brenda afateve dhe detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”.

2. Të gjitha subjektet që do të aplikojnë për t’u pajisur, me leje minerare apo transferim të lejes minerare, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji minerar i Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimet përkatëse në fuqi, duhet të realizojnë dhe paraqesin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kontratën për sigurimin ndaj aksidenteve të punonjësve.

3. Të gjitha subjektet minerare, që janë të pajisura me leje minerare dhe që sot zhvillojnë veprimtari minerare brenda një periudhe 90-ditore nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”, duhet të realizojnë dhe paraqesin pranë Drejtorisë së Licencave dhe Menaxhimit të Kontratave, dokumentet që vërtetojnë realizimin e një sigurimi të tillë. Fillimi ose vazhdimi i veprimtarisë minerare do të kryhet pas konfirmimit nga DLMK-ja, që një sigurim i tillë është në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë” dhe këtij udhëzimi.

4. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit, sipas dëmtimeve shëndetësore të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të pikës 8 të nenit 14 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, do të jenë si kushte minimale të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve për sigurimin e punonjësve që punojnë në aktivitete minerare.

5. Kontratat e sigurimit kolektiv duhet të jenë nominale për çdo punonjës të punësuar nga subjekti minerar. Për çdo ndryshim të numrit të punonjësve që përfshihen në kontratën e sigurimit, duhet të reflektohen në këtë kontratë. Çdo punonjës i ri mbi numrin e personave të përfshirë në kontratën e sigurimit kolektiv, duhet të sigurohet sipas kërkesave të këtij udhëzimi nëpërmjet realizimit të një kontrate të re sigurimi. Një kopje e kësaj kontrate i dërgohet, brenda 30 ditëve nga marrja në punë, Drejtorisë së Licencimit dhe Menaxhimit të Kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për t’u vendosur në dosjen e subjektit.

6. E gjithë periudha e veprimtarisë minerare e përcaktuar në lejen minerare, duhet të jetë e mbuluar nga kontrata e sigurimit nëpërmjet sigurimit vjetor të rinovueshëm për çdo vit ose për të gjithë kohën e kësaj veprimtarie.

7. Për rastet e transferimit të lejes minerare te një subjekt tjetër, subjekti i pajisur me leje minerare të transferuar, duhet t’i rinovojë me emrin e tij edhe të gjitha kontratat e sigurimit të punonjësve që ka pasur subjekti i parë. Në të kundërt nuk bëhet transferimi i lejes.

8. Subjekti i pajisur me leje minerare të transferuar, është i detyruar të zbatojë të gjitha kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”, si dhe këtë udhëzim, për sigurimin e punonjësve që trashëgon ose merr të ri në objektin minerar ekzistues.

9. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave do të kryejnë, përveç kontrollit për sigurimin teknik në subjektet e pajisura me leje minerare, edhe kontrollin për sigurimin e punonjësve të punësuar në këto subjekte.

10. Kontrolli i ushtruar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, bëhet për sigurimin e punonjësve, duke e vlerësuar sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, në këto subjekte, si masë e rëndësishme parandaluese për aksidentet në punë.

11. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave të paraqesin çdo 6 muaj pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës informacionin përkatës nga kontrollet e ushtruara, për gjendjen e sigurimit të punonjësve në subjektet e licencuara.

12. Drejtoria e Licencimit dhe Menaxhimit të Kontratave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mbi bazën e raporteve të AKBN-së dhe RISHM-it, të evidentojë gjendjen e fuqisë

punëtore aktuale në subjektet e licencuara dhe çdo gjashtë muaj të rakordojë me zyrën e sigurimeve shoqërore për gjendjen e raportuar nga subjektet.

13. Çdo subjekt i pajisur me leje minerare, pas kalimit të afatit 90-ditor të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”, nuk do të ushtrojë veprimtarinë e tij minerare pa paraqitur kontratën e sigurimit për punonjës dhe të konfirmuar jo nga strukturat përgjegjëse sipas pikës 11 të këtij udhëzimi. Mosrespektimi i një detyrimi të tillë është shkelje e dispozitave të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar dhe do të trajtohet sipas kapitullit të masave ndëshkuese të këtij ligji me vlerën e gjobës jo më pak se 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë.

Në rastin e një shkeljeje të përsëritur, ndaj subjektit fillojnë procedurat e heqjes së lejes minerare sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, i ndryshuar.

14. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore t’i njoftojë zyrtarisht të gjitha subjektet e licencuara, si dhe sindikatat për daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë”.

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Drejtoria e Licencimit dhe Menaxhimit të Kontratave, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave.

16. Ky udhëzim hyn në fuqi dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.1662, datë 25.8.2008

**PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PASHPËRNDARË TË MBROJTJES
SOCIALE**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.4, datë 17.1.2008 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2008”,

UDHËZOJ:

1. Fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale përdoret për mbështetjen me fonde:

a) për familje apo individë në nevojë në raste fatkeqësish me vdekje nga aksidente në punë, sëmundje të rënda, fatkeqësi nga zjarri, përmbajtje apo fatkeqësi të tjera natyrore;

b) të njëjsteve vendore për programimin e ndihmës ekonomike, pagesën për aftësinë e kufizuar, për plotësimin e nevojave të paparashikuara dhe emergjente, si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në nivelin e varfërisë së familjeve banuese në juridiksion të territorit të tyre, ndryshimit të nivelit të papunësisë dhe punësimit;

c) të shërbimeve sociale komunitare që ofrohen në qendra rezidenciale, ditore, shërbime në shtëpi, shërbimin e kujdestarisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, të rinjve dhe grave në nevojë.

2. Për shpërndarjen e fondeve, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta krijohet një komision me 5 anëtarë. Komisioni kryesohet nga Ministri dhe anëtarët e tij janë Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit Financiar.

3. Komisioni mblidhet periodikisht dhe vlerëson kërkesat që vijnë nga njësitë vendore, për mbështetjen e individëve, familjeve, grupeve që konsiderohen në nevojë dhe i paraqet Ministrit

propozimin për shpërndarjen e këtij fondi.

4. Njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat paraqesin projektet dhe propozimet e tyre për mbështetje nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale sipas germave “a”, “b” & “c” të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Kërkesat për shërbimet sociale komunitare, germa “c” e pikës 1, bëhen sipas modularit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë vendore dhe mendimin e saj me shkrim, së bashku me projektet e propozuara, i percjell në komisionin e MPÇSSHB për shqyrtim e miratim.

6. Kërkesat për mbështetje nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale që paraqesin njësitë e qeverisjes vendore mbështeten dhe argumentohen me:

a) Treguesit e nivelit të varfërisë që kanë njësitë vendore sipas vlerësimeve të LSMS dhe kritereve të ndihmës ekonomike.

b) Vlerësimin e nevojave për shërbime sociale në territorin e tyre.

c) Nivelin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror që ofrohen aktualisht nga subjektet publike dhe jopublike në njësinë vendore.

d) Numrin e përfituesve të shërbimit, nivelin e zbatimit të standardit të shërbimeve për përfituesit në nevojë dhe performancën e mëparshme të shërbimit.

e) Kontributin e njësisë vendore në mjete financiare ose në kapitale të trupëzuara të vëna në dispozicion të ofrimit të shërbimit social për të cilin kërkohet financim.

f) Treguesit, përfitues në ndihmë ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, personat, pjesëtarë të familjeve ku nëna është kryefamiljare, persona pjesëtarë në grupet në nevojë, pjesëtarë të familjeve rome, jetimet familjare për individët që do të përfitojnë mbështetje financiare.

7. Mbështetja nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale për shërbimet sociale rezidenciale apo komunitare, si dhe për ngritjen e shërbimeve të reja komunitare për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, të rinjtë dhe grave në nevojë, bëhet vetëm për ushqim, pagat dhe sigurimet shoqërore të profesionistëve që ofrojnë drejtpërsëdrejti shërbime me klientët, si edukator, punonjës social, psikolog, mjek, infermier.

8. Të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme për funksionimin e shërbimeve sociale komunitare për personelin administrativ dhe shpenzimet operative, si energji, ujin, kancelari etj., mbulohen nga vetë njësia vendore.

9. Fondi i miratuar nga komisioni, për mbështetje sipas germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1, delegohet si transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore, nga MPÇSSHB.

10. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të këtij fondi.

11. Njësitë e qeverisjes vendore ndjekin procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e ofruesit të shërbimit sipas germës “c” të pikës 1 të këtij udhëzimi, fitues i projektit të miratuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

12. Këshilli i bashkisë ose komunës merr vendim për përdorimin e këtij fondi, për qëllimin që është dhënë, së bashku me kontributin e njësisë së qeverisjes vendore.

13. Për raportimin e realizimit të përdorimit të fondit, të ndiqet e njëjta procedurë si veprohet për programin e ndihmës ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuara.

14. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të paraqesin treguesit statistikorë për shërbimet shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Kosta Barka

PROJEKTPROPOZIM OSE PROJEKT PËR SHËRBIMET SOCIALE

1. Vlerësimi i propozimit të projektit

1.1 Titulli i projektit

1.2 Bashki

Komunë

1.3 Kohëzgjatja e projektit
në muaj

1.4 Kosto e propozuar për t'u
financuar nga fondet
buxhetore

1.5 Kontributi i njësisë
vendore (lekë)

1.6 Kontribute të tjera (lekë)
ndërtesa, staf, pagesa nga
përfituesi etj.

1.7 Buxheti total (lekë)

1.8 Numri i vlerësuar i
përfituesve direkt

1.9 Kosto e vlerësuar për një
përfitues/klient (lekë)

1.10 Tipologjia e shërbimeve

☐	qendra ditore	☐	shërbimi në familje	☐	qendra multidisciplinore	☐	qendra informacioni dhe këshillimi
☐	kujdestar	☐	strehëza të përkoshme	☐	të tjera		

1.11. Problematika që do të adresojë projekti i propozuar

1.12. Grupet e adresuara:

1.13. Fillimi i projektit: data _____ muaji _____

1.14. Përfundimi i projektit: data _____ muaji _____

2. Informacioni i përgjithshëm mbi projektin

2.1 Emri i projektit:

2.2 Bashkia/komuna

2.3 Gjendja e shërbimit:

☐
☐

Ekzistues

☐
☐

I ri

2.4 Gjendja e infrastrukturës:

☐
☐

Rehabilitim

☐
☐

I ri

☐
☐

Zgjerim

2.5 Qarku ku bën pjesë:

2.6 Përshkruani shkurt vendin e zbatimit të projektit:

3. Shërbime ekzistuese¹

¹ Ky seksion vlerëson eksperiencën e bashkisë/komunës me qëllim vlerësimin e kapaciteteve potenciale për të

3.1 Përshkruani tipin e shërbimit të ofruar nga pushteti qendror, pushteti lokal, OJF apo qendra komunitare dhe numrin e përfituesve të këtij shërbimi.

Tipin e shërbimit/ grupi i adresuar	PAK	Fëmijë në risk	Të rinj në risk	Gra dhe fëmijë në risk	Të moshuar në risk	Të tjerë
Institucioni rezidencial						
Qendër ditore						
Shërbim komunitar						
Shkolla						
Qendra shëndetësore						
Programe parandaluese						
Diagnostikimi i hershëm						
Qendra multidisciplinare						
Strehëza të përkohshme						
Qendra informimi dhe këshillimi						
Shërbime në familje						
Kujdestari						
Të tjera						

3.2 Përshkruani preceptimin/ndjesinë e klientëve apo përfituesve ndaj cilësisë së shërbimit të ofruar.

zbatuar projektin e propozuar.

3.3 Staf administrativ (përshkruaj) _____

3.4 Numri i përfituesve direkt:

3.5 Numri i stafit administrativ:

3.6 Numri i stafit profesionit:

3.7 Raporti staf i përgjithshëm/përfitues

3.8 Raporti staf profesionistë/përfitues:

4. Shërbimet e mëparshme dhe shërbimet aktuale të ofruara për këtë target grup

Lloji i shërbimit	Nr. i përfituesve direkt	Periudha vite	Kostoja	Burimi i financimit

4.1 Eksperienca e bashkisë/komunës/OJF

Emri i bashkisë/komunës/OJF	Shërbimi i ofruar nga bashkia/komuna/OJF			Periudha

5. Prezantimi i problemit

5.1 Tregoni problemin që do të adresojë nënprojekti.

6. Qëllimi dhe objektivi

6.1 Qëllimi i projektit

6.2 Objektivat e projektit, aktivitetet dhe rezultatet e projektit

Objektivat e projektit	Indikatorët	Mjetet e verifikimit	Rreziqet/supozime

6.3 Rezultatet e pritshme

Rezultati	Grupi target	Nr.i përfituesve direkt	Nr.i përfituesve indirekt	Qarku i targetuar

7. Qëndrueshmëria e projektit

7.1 Listoni kostot për stafin profesionist që do të mbulohen nga fondet e buxhetit qendror dhe kostot operative për 3 vitet e ardhshme që do të mbulohen me fondet e bashkisë/komunës.

Kosto	Burimi potencial i financimit	Shuma (lekë)
1. Fondet nga buxheti qendror	MPÇSSHB	
1.1 Pagat dhe sigurimet shoqërore për stafin profesionist		
1.2 Kosto për ushqimin për rastet e qendrave rezidenciale		
1.3 Shërbime konsulence (trajnime)		
2. Fondet nga buxheti lokal	Bashki/komunë	
2.1 Pagat e stafit administrativ		
2.2 Shpenzime operative Uji Elektriciteti Telekomunikacioni Ngrohje		
2.3 Mirëmbajtja & operacionet		
2.4 Qira		
2.4 Transporti & mirëmbajtja		
2.5 Të tjera		
3. Fondet nga donatorë		
3.1 Donatori		
Nëntotali i kostos operative		
TOTALI		

7.2 Listoni stafin që nevojitet për të ofruar shërbimin.

Specialiteti i stafit	Numri i stafit	Pagat në total	Stafi rezistent ose që do të rekrutohet

7.3 A do të ketë pagesë nga klienti?

☐

Po

☐

Jo

7.4 Ju lutem përshkruani skemën e pagesës nga klienti

8. Zbatimi i projektit

8.1 Aktivitetet e kërkuara për zbatimin e projektit

Nr.	Aktiviteti	Kohëzgjatja (në muaj)	Personi ose njësia përgjegjëse

8.2 Cila është kohëzgjatja për zbatimin e projektit?

9. Plani i monitorimit dhe indikatorët

Ju lutem vendosni tabelën e matësve të indikatorëve, mënyrat dhe kalendarin e verifikimit.

Indikatorët e performancës	Mekanizmat e mënyrës së verifikimit/raportimit	Kalendari

10. Miratimi dhe konfirmimi

Emri _____ Pozicioni _____
Firma _____ Data _____

Emri _____ Pozicioni Përfaqësuesi bashkisë/komunës
Firma _____ Data _____

URDHËR Nr.350, datë 5.9.2008

PËR MIRATIMINE E STATUSIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP LIQENI I FIERZËS, KUKËS)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statusit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) liqeni i Fierzës, Kukës, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Lufter Xhuveli

KËRKESË

Shtetasi Nexhmi Kasa, i biri i Qazimit dhe i Rukijes, i dtëlindjes 1963, lindur në Kocaj të

Komunës Baldushk dhe banues në Farkë të Vogël-Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të xhaxhait të tij
Hajdar Hasan Kasa

KËRKUESI
Nexhmi Kasa

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.9.2008
Doli nga shtypi më 23.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë